

KOSOVARIA


Ballina: Dion Arbëri

SHQIPTARI DION ARBËRI

U PËRSHËNDET PERSONALISHT
NGA DONALD TRUMP

PSE
TË FAMSHMIT
SHQIPTARË
VDESIN
NË JANAR

REXHEP REXHEPI
JETOI ME 24 PLUMBA
NË TRUP





SHERWOOD
Resorts and Hotels



GREENWOOD
Resorts and Hotels

feel the legend



SHERWOOD
Exclusive Icons



SHERWOOD
Exclusive Wood



SHERWOOD
Exclusive Stone

BLUE

TRIBUTE
Sera



SHERWOOD
Premium



GREENWOOD
Exclusive Emerald



GREENWOOD
Exclusive Emerald

www.sherwoodhotels.com.tr | www.greenwoodhotels.com.tr

+90 444 88 07

Pse të famshmit shqiptarë vdesin në janar?

Janari është muaji më i ftohtë i vitit. Por, edhe muaji kur disa nga personalitetet më të mëdha të kombit tonë kanë vdekur...



SKËNDERBEU

Gjergj Kastrioti (Skënderbeu), i lindur më 1405, vdes më 17 janar 1468.

Ishte udhëheqës ushtarak arbër, që në fillësë luftoi për Perandorinë Osmane dhe më pas, 25 vjet, drejtoi një kryengritje kundër saj. Si anëtar i familjes fisnike të Kastriotëve, u dërgua si peng në oborrin perandorak osman, ku u arsimua dhe hyri në shërbim të sulltanit për njëzet vitet e ardhshme. U ngrit sipas gradave, duke u bërë deri sanxhakbej i Sanxhakut të Dibrës në vitin 1440.

Më 1443 dezertoi nga ushtria osmane gjatë betejës së Nishit dhe u bë sundimtar i Krujës.

Në vitin 1444 themeloi Lidhjen e Lezhës me mbështetjen e fisnikërisë bashkëkohëse.

Luftoi kundër osmanëve deri në vdekjen e tij, në janar të vitit 1468.

DR. IBRAHIM RUGOVA

Themeluesi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, lëvizje rreth së cilës qenë tubuar pjesa dërmuese e shqiptarëve të Kosovës në vitet 90, e pas lufte edhe kryetar i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova ndërroi jetë më 21 janar 2006, në orën 11:38, në rezidencën e tij në lagjen "Velania" të Prishtinës.

Më 23 janar 2006 funerali me trupin e Presidentit Rugova u vendos në hollin e Kuvendit të Kosovës.

Aty qytetarët kishin mundësinë t'i bënin homazhe Presidentit dhe t'i bënin nderimin e fundit për 3 ditë me radhë.

Varrimi i Presidentit u bë më 26 janar 2006. Në varrim kanë marrë pjesë rreth 700 mijë qytetarë. Në varrimin e Presidentit Rugova morën pjesë shumë delegacione zyrtare nga tërë bota, miq të Kosovës: Delegacioni i SHBA-ve; Delegacioni i Bashkimit Evropian; Delegacioni nga zyra e UNOSEK-ut; Delegacione nga Austria, Britania, Belgjika, Shqipëria, Gjermania, Spanja, Franca, Sllovenia, Kroacia, Maqedonia, Greqia, disa vende afrikane etj.



DR. ZEKERIA CANA

Dr. Zekeria Cana vdiq më 10 janar 2009, në moshën 75-vjeçare.

Profesor Cana është shquar për vlerat e larta profesionale dhe si hulumtues shkencor i periudhës më të re historike.

Ai ka publikuar një sërë punimesh shkencore nga lëmi i historisë. Ka qenë shumë aktiv për veprimtarinë e tij patriotike për çlirimin e vendit, ndërsa do të mbahet mend, sidomos, për kontributin që ka dhënë në kohën e pajtimit të gjaqeve në Kosovë.

Zekeria Cana në vitet 90 qe bërë simbol i rezistencës ndaj dhunës, përndjekjeve, tmerreve dhe vrasjeve shqiptare.

Dita e ndarjes prej tij ishte ditë pikëllimi jo vetëm i familjes, i farefisnisë, shokëve e miqve, por ishte ditë pikëllimi i gjithë atyre që dinë ç'është dinjiteti njerëzor dhe mbrojtja me çdo kusht e këtij dinjiteti.

Në ballinë: Dion Arbëri

Shqiptari Dion Arbëri

u përshëndet personalisht nga Donald Trump në darkën luksoze të fundvitit!

Resursi më i madh e më i çmuar i kombit tonë, pa dyshim, është rinia. Të zgjuar, të aftë, të talentuar, inovativë, të pashëm.

Një shembull i shkëlqyeshëm është edhe Dion Arbëri, 24-vjeçari shqiptar i suksesshëm në fushën e ekonomisë, i cili arritet e tij ka dashur t'i mbajë larg syrit të publikut, duke mos preferuar që të jetë në fokus dhe vëmendje mediatike.





Prania e Dion Arbërit në festën luksoze të fundvitit, organizuar nga ish-Presidenti i SHBA-ve, Donald Trump, nuk mund të

shpërfilej.

Trump, një nga njerëzit më të fuqishëm në botë sa i përket fushës së biznesit dhe ish-President ikonik, në fundvitin e 2023-shit ka organizuar, si gjithmonë, darkë luksoze me persona influentë e të rëndësishë së lartë, ku këtë herë ishte i ftuar edhe ekonomisti shqiptar Dion Arbëri.

KUSH ËSHTË DION ARBËRI, SHQIPTARI QË U PËRSHËNDET PERSONALISHT NGA DONALD TRUMP?

Siç kuptojmë, i riu Dion Arbëri, që u pikas nga mediet në banketin e madh e luksoz të fundvitit, të mbajtur në hotelin e



ri e luksoz "Maralago", në Florida, ku ishin të pranishëm njerëz të afërt të Trumpit: familjar, shoqëri e bashkëpunëtorë. Dion Arbëri është ekonomist nga Kosova, i cili jeton dhe vepron në Zvicër, i diplomuar për Banka dhe Financa në Universitetin e Cyrihut. Arbëri, djaloshi i pashëm, të cilit iu zgjatë dora personalisht nga Trumpi, punon si "Precious Metals Traders", në "Wealth Management".

Ndryshe, Dion Arbëri është i biri i biznesmenit të njohur, Jimmy Arbëri, pronar i qindra objekteve në vende shumë atraktive në qytetin e Cyrihut dhe biznesmen me famë në fushën e shitblerjes dhe hotelierisë.

Nderim Neziri



Me rastin e vdekjes

Rexhep Rexhepi jetoi me 24 plumba në trup!

Ditë më parë, në moshën 76 vjeç, ndërroi jetë dhe u varros me nderime Rexhep Rexhepi, nga fshati Gjylekarë i Gjilanit, burrë që u mbijetoi 24 plagëve të luftës. Rexhep Rexhepi, me plagët dhe plumbat që barti në trup për 25 vjet, ishte dhe mbetët sinonim i qën-

dresës së popullit tonë ndaj dhunës, torturës dhe vrasjeve që ka ushtruar pushtuesi serb ndaj popullit të Kosovës, në përgjithësi, e banorëve të fshatit Gjylekarë në veçanti, në atë ditë të kobshme të 15 prillit të vitit 1999, ku u vranë 6 vetë e u plagosën 17 të tjerë.

Dhe, në atë krahurë lufte, Rexhep Rexhepi mori 24 plagë nga plumbat e armikut dhe me to jetoi deri para pak ditësh...

Andaj, me jetën, durimin dhe sakrificën e tij, sikur tha: "Nuk vdiset nga plumbat e armikut!".



Një çadër për tërë familjen



Foto nga Peja e dikurshme

ASKUSH S'DURON SA NJERIU!



S'ka gjë më të fortë se njeriu!
Pse?

Se e liga i ra lisit e u tha; i ra gurit e u çau; i ra malit e u shembë; i ra lumit e u shterë.
E, kur i ra njeriut – duroi...
Andaj, a ka gjë më të fortë se njeriu?!

*

Një plak, duke ecur rrugës, i pa dy fëmijë teksa grindeshin për një arrë.
U tha: "Më lejoni t'ua ndaj të dyve!"
E theu arrën. Por, kur pa se brendia e saj ishte bosh, me butësi u tha: "Kjo është arra për të cilën grindeni! A ia vlen?!".

*

Plaku di shumë, por nuk e pyet kush!
Diellin të gjithë e duam, por kur na djeg ikim nën hije!

Dashuria është një luftë ku nuk ka të vranë, por të plagosur në shpirt po!
Përherë jemi në vendin ku janë mendimet tona, por jo edhe në vendin ku është trupi ynë...
Njerëzve fillon t'u mungosh kur të shohin të lumtur me dikë tjetër!
Njerëzit të bëjnë ta duash edhe vetminë!

*

"Shpinën ta kthejnë ata që s'kanë fytyrë",
thoshte im plak.
E, nëse nuk largohesh nga njerëzit e gabuar,
kurrë s'do të takohesh me të duhurit...

*

Kur ngrihesh, shokët e kuptojnë kush je.
E, kur rrezohesh, e kupton se kush janë shokët...

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)
Nderim Neziri (redaktor)
Besiana Dili
Drenushë Haredinaj
Ardita Dili
Edona Vllasaliu - Bajoku
Xheneta Spahiu
Denisa Oruqi

Dizajni:

Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Kemi pritur shumë që të jemi Kosovë dhe Shqipëri dhe sot ja ku jemi. Vijmë e shkojmë lirshëm, por kjo nuk na mjafton, sepse ne duam për inate të tjerëve të bëhemi zyrtarisht bashkë dhe të vuajmë edhe më shumë nga bashkimi enorm dhe euforik. Jemi bërë popull patriotik, por nuk po nxjerrim gjë në dritë...

E kishim lënë të merreshim vesh me një letër. Duhej ta lija te varri i babait, nëse ai do të vdiste para se të bëhej Kosova shtet.

Babai e kishte në shpirt "Ballin Kombëtar". E donte vetëm pse ishte partia që i donte të gjithë shqiptarët bashkë, nën një çati politike.

Por, në kohën e tij nuk ishte arritur të jetësohej kjo ide...

Dy herë e kishin dërguar në ushtrinë e Jugosllavisë, me pretekst se nuk e kishte kryer shërbimin komplet...

Ai ishte dërguar që të vritej në Tivarin e përgjakshëm, pas një udhëtimi këmbë nëpër Shqipëri, por fati kishte qenë në anën e tij dhe ishte kthyer gjallë.

Dhe, edhe në këtë lloj jete nuk e kishte braktisur nga mendja idenë se Kosova duhej t'i bashkohej Shqipërisë.

Mbaj mend një polemikë mes tij dhe një serbi, që kishte dalë në gjueti. Kishte ardhur serbi me dy zagarë gjahu dhe ishte futur në arën tonë.

Babai e mori qenin tonë dhe i doli para.

Jemi bërë të gjithë patriotë!

"Këtu nuk bëhet gjuetia!", i tha babai, aq më shumë kur e njohu se kush ishte.

Ai i tha se nuk e dinte se e kujt ishte ara, por babai ia kujtoi se këndejanë arat e katundit tonë dhe nuk bëhet gjahu në to.

"Jemi një, o shok, jetojmë në një shtet, në një vend se tash jemi vëllazërim-bashkim!", i tha serbi babait tim.

Por, ende pa e mbaruar fjalën, babai ia ktheu:

"Nuk jemi unë dhe ti një, as nuk kemi qenë kurrë!

Po të ishim një, ti nuk do flisje serbisht, por do flisje shqip.

Po të isha unë si ti nuk do flisja shqip, por serbisht. E, kjo na ndan: unë flas shqip e ti serbisht dhe këto dy gjuhë nuk kanë bash asgjë të përbashkët mes vete, prandaj

edhe i kemi historitë ndryshe..."

Dhe, pas këtyre fjalëve të ashpra i tha që të largohej sa më shpejt nga ara jonë dhe të mos e shohë më në këto anë...

Pas kësaj babai u dergj një kohë dhe vdiq në mars të vitit 1999, më 19 mars, ditë e shtunë, herët në mëngjes.

Ndërkaq, Kosova u çlirua në qershor të atij viti.

Por, dy ditë para se të vdiste, më tha:

"Eja te varri dhe më trego për ngjarjet që do të ndodhin në Kosovë!"

KANË NDRYSHUAR GJËRAT, JEMI BËRË SHUMË PATRIOTË!

E, çka t'i them babait tash?! Ka ndryshuar shumëçka prej

atëherë në Kosovë dhe kjo nuk vlen vetëm për babanë tim, por edhe për të tjerët që mund të kishin pasur kërkesa të ngjashme, sepse as ai nuk ishte më shqiptar se shumë e shumë të tjerë që kishin rënë në prita, në luftëra e në përballje... Sidoqoftë, partia e babait tim më nuk ekziston. Partia i thoshe "Balli Kombëtar" më nuk ndihet shumë gjallë dhe në Kosovë ajo është një relikto delikat. Në Kosovë tash shëtit lirshëm fuqia ushtarake e NATO-s dhe ëndrrat kanë ndryshuar... Ne tash e shkelim Shqipërinë pa asnjë frikë, por sërish nuk jemi të kënaqur, sepse kërkojmë bashkim zyrtarisht. Duam që kjo gjë të zyrtarizohet me akte, ligje, kushtetutë dhe që, njëherë e përgjithmonë, ta zgjidhim çështjen e Kosovës, por edhe t'ia plasim zemrën Serbisë... Sepse, edhe ti e doje këtë gjë apo jo, babë? E doje ëndrrën, tokën shqiptare, por afër e kishe edhe pushkën, sepse pa të nuk kishe jetë... Sidoqoftë, tash është një mishmash.

Nuk dimë kujt t'i besojmë!

KEMI POLITIKANË QË E DUAN MË SHUMË RRUGËN SE PARLAMENTIN!

I dashur baba, kemi shumë liderë politikë nga bota e re shqiptare dhe politike! Kemi shumë parti dhe secila del më e dijshe se tjetra! Ka edhe në Parlament që nuk e duan Kosovën e Hashim Thaçit, por duan një Kosovë tjetër! Dhe, nuk dinë as vetë se çfarë Kosove duan! Andaj, babë, ëndrrat kanë mbetur si në poezi... Kemi edhe "patriotë" që nuk po zgjedhin metoda e as mënyra si të vihet te pushteti. Secili njeri do pushtet, duke menduar se është më i mençuri! Jemi duke u marrë me lumturimin tonë të paqenë! Jemi duke jetuar në shtetin e gjobave të fukarenjve, ndërkohë që fabrikat nuk punojnë... Në Kosovë prodhohen vetëm makiato dhe, siç po thonë edhe ndërkom-bëtarët, makiato më të mira nuk gjen kund! Por, më e keqja po ndodh çdo ditë: pasurohen zyrtarët, varfërohet populli...

Sokol Murturi



Bëhu e bukur si Flaka Vitaku!

Dikur studente në AAB, madje edhe kryetare e Unionit të Studentëve të këtij kolegji, tash në Televizionin ATV profesioniste dhe sharmante, Flaka Vitaku po ia del me sukses punës në botën e televizionit, me një qasje mjaft unike në intervista dhe prezantim.

Imazhi i saj është bukuria që ia ka falur Zoti, por edhe aftësia për prezantim shumë të suksesshëm.

Andaj, është mirë që nënat t'i urojnë vajzat e tyre që të bëhen të bukura e të zonja si Flaka Vitaku...

Kush po e gjen shpëtimin te viagrat?

Disa njerëz, sidomos biznesmenët e pensionistët, janë në hall me gratë dhe dashnoret e tyre. E, për t'u dalë zot, shpëtimin e gjejnë te viagrat...

Bashkëbiseduesit tanë janë të bindur se me të madhe janë duke u përdorur viagrat, edhe pse, sipas mjekëve, ato janë të rrezikshme dhe mund të shkaktojnë edhe

vdekjen.

Shqetësues është fakti i përdorimit të viagrave sidomos nga të moshuarit, sepse vetëm vitin e kaluar kanë ndodhur disa raste kur të moshuarit kanë ndërruar jetë nëpër motele!

E, një gjë e tillë, me siguri, ka qenë pasojë e përdorimit të viagrave, të cilat, në masë të madhe, e rrisin tensionin e lart të gjakut.

Por, për disa kjo nuk ka rëndësi, meqë për ta e rëndësishme është që gjithmonë të jenë në top-formë dhe t'i kryejnë "detyrat e shtëpisë" siç duhet...

Në të kundërtën, gratë e pakënaqura në seks nga burrat e tyre, i tradhtojnë ata, meqë te ta nuk e gjejnë lumturinë e nevojshme seksuale...

Por, kjo është e tmerrshme, meqë lumturia në çift nuk lidhet vetëm me seksin, por edhe me gjërat e tjera të jetës së përditshme, si harmonia në familje, jeta e mirë familjare, harmonia me fëmijë, mirëkuptimi i mirë bashkëshortor, e të tjera të ngjashme...

Andaj, të lumtur janë ata që nuk kanë nevojë për viagra...

Diturie Haxhaj



NË PRIZREN MA T'BUKURIN VEND!

KOMPLEKSI DARDANIA

+383 48 450 888
www.cimaks.com



KOMPLEKSI CIMA TOWER

Rr. Cenë Dugollë, Ferizoj



Blloku C - Tipi T4
Superfaqja: 140.00m²



+383 49 601 080
www.cimaks.com

Lumnije Kqiku, ambasadorja e shkencës në botën shqiptare

Prof. Lumnije Kqiku - Biblekaj është një nga autoritetet botërore me prestigj të lartë - model i një gruaje të suksesshme.

Njihet për arritjet e saj në të gjitha nivelet akademike në moshën e saj të re shkencore dhe mbetet motiv për shumë gra anekënd botës.

Edhe pse jo e lehtë për të, mbetet në trendin e zhvillimeve më të reja, ku, me punën e saj të palodhshme dhe guximin, ofron një model ndryshe të vepruarit në shkencë e studime ndërkombëtare. "Suksesi im është evident dhe jam

krenare që përfaqësoj kombin tim. Jam e pranishme në takimet më të avancuara të nivelit ndërkombëtar.

Dhe, të depërtosh në portat e botës dhe të tregosh rrëfimin tënd të suksesit të madh, është edhe nder dhe krenari.

E para, se jam nga Kosova; E dyta, se i rangoj Kosovën dhe shqiptarët në hierarkinë e shkencës botërore", tha ajo për revistën tonë, "Kosovarja".

I KA PËRJETUAR TË GJITHA ARRITJET SHKENCORE

Dr. Lumnije Kqiku i ka përjetuar të gjitha arritjet shkencore dhe pretendon se e ardhmja e saj është akoma më aktive në shkencë. "Shkenca nuk ka kufij, sepse ajo zhvillohet me kalimin e kohës edhe më shumë.

Nuk guxojmë të stagnojmë e as të krekosemi se kemi arritur rezultate finale apo kulminante.



Duhet të ecim me kohën dhe durimi im e i kolegëve të mi i kushtohet shkencës, dijes, vlerave universale dhe atyre që kanë dëshirë të prosperojnë në fusha të ndryshme”, shprehet ajo.

Lumnije Kqiku, e cila tashmë ka përfituar titullin ambasadore e shkencës në botën shqiptare, jep edhe një mesazh për shqiptarët kudo që ndodhen në botë dhe janë të angazhuar ose mendojnë të angazhohen në tituj shkencorë dhe hulumtime të avancuara studimore.

“Mos u dorëzoni në asnjë moment! Mos u largoni nga dëshirat tuaja për të arritur në hierarkinë e njerëzve më me ndikim në shkencë, sepse gjithçka është e mundur dhe gjithçka varet nga këmbëngulja juaj dhe intelekti për ta finalizuar një ëndërr tuajën!

Unë jam kudo, me ju e pranë jush, sepse kam përkrahur dhe vazhdoj të përkrah pa asnjë interes kuadrot shkencore nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, e kudo në trojet shqiptare” shton ajo.

...EDHE NË “WOMAN IN GLOBAL HEALTH”

Dr. Lumnije Kqiku, si nënë e tre fëmijëve, duket se përpos shkencës ka vendosur ta përfaqësojë veten dhe kombin shqiptar edhe në “WOMAN IN GLOBAL HEALTH”, komunitet ky që boton biografitë e anëtarëve të saj aktivë, të cilët shquhen për arritjet e tyre dhe karrierën e jashtëzakonshme, sidomos të atyre që njihen si “gra të forta”.

E, ndër temat kyçe që kanë lënë gjurmë dhe shquhet dr. Kqiku në këtë aktivitet janë: Gratë udhëheqëse në shëndetin global; gratë në shkencë; të drejtat e grave dhe fëmijëve; si dhe fuqizimi i grave.

Ajo ka marrë shumë çmime kërkimore dhe është ftuar në shumë

vende ku ka mbajtur leksione të shumta “keynote” dhe ka shërbyer si eksperte e fushës.

E NDERUAR ME MEDALJE TË ARTË

Në prill të vitit 2023, Dr. Lumnije Kqiku është nderuar me çmimin “Personalitet Nderi me Medalje të Artë”, nga Qyteti i Gracit të Austrisë, manifestim në të cilin ishin të pranishëm pothuajse gjithë qeveria e qytetit, si dhe kryebashkiakja e Gracit, Elke Kahr, e cila, me atë rast, ka theksuar: “Mirënjohja është gjëja më e thjeshtë për t’u thënë faleminderit!”.

Ndërsa, Kqiku kishte thënë në ditën e ndarjes së çmimit: “Çmimi i fundit që u nderova nga qyteti i Gracit për të arriturat shkencore “Personalitet nderi me medalje të artë”, është çmim që na nderoi të gjithëve si komb dhe do të vazhdoj ta përfaqësoj atë kudo që jam”.

ÇFARË PUNON DHE PËR ÇFARË NJIHET DR. LUMNIJE KQIKU?

Është e lindur në Gjilan. Shkollimin fillor dhe të mesëm i përfundoi në Kosovë, ku edhe i vazhdoi studimet në Fakultetin e Mjekësisë, Dega e Stomatologjisë, në Universitetin e Prishtinës.

Në vitin 2003 nostrifikoi diplomën e Fakultetit në Universitetin Mjekësor të Gracit në Austri, ku edhe mbrojti magjistraturën.

Në vitin 2006 përfundoi doktoratën dhe u promovua në specialiste të endodoncisë.

Gjatë viti 2007 ishte në vizitë studimore në Fakultetin e Stomatologjisë në Universitetin e Zagrebit, e në vitin 2010 në Universitetin Mjekësor të Tübingen-it, Gjermani. Në vitin 2018 fiton titullin e profesorit. Është profesoreshë në Universitetin e Gracit.

Është autore dhe bashkautorë e punimeve të shumta profesionale dhe shkencore.

Është anëtare e shumë shoqatave dentare vendore dhe ndërkombëtare, njëherësh edhe recensente e shumë revistave shkencore dentare, e që me punën e saj të palodhshme, guxim dhe dituri, e bëjnë zonjë të dalluar, karriera e së cilës është frymëzuese për rrugën e suksesit.

Është udhëheqëse e Klinikës Speciale të Endodoncionit dhe Traumatologjisë Dentare në Klinikën Universitare në Grac të Austrisë, si dhe udhëheq rrjetin Ceepus (Central European Exchange Program for University Studies) për Klinikën Universitare Stomatologjike të Gracit.

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
shkabaj për Android

ANDROID APP ON
Google play

Bukuria femërore është kthyer në sëmundje sociale!

Përderisa në kohët e “lashta” edukoheshim se fuqia e një femre është mençuria dhe nderi i saj, tash, duke vrapuar me kohën, e kemi zëvendësuar këtë urtësi me mendimin se fuqia e një femre në shoqërinë tonë shqiptare më nuk është mençuria, por bukuria dhe trupi i saj, duke krijuar një ideologji feministe të shëmtuar dhe kontradiktore me vlerat e femrës shqiptare.

PSE BUKURIA FEMËRORE ËSHTË KTHYER NË SËMUNDJE SOCIALE?

Për sa kohë që në psikologjinë tonë pamja dhe trupi luajnë një rol kaq të spikatur në vetëvlerësimin dhe vetëportretizimin tonë, do ta kemi të vështirë të distancohemi nga

ky obsesion hipokrit. Edhe nëse Mikelanxhelo do të ringjallej, do ishte në dilemë të madhe karshi idealit të mbivlerësuar për bukurinë femërore që, fatkeqësisht, është kthyer në një lloj sëmundje sociale.

Ky imazh “perfekt”, e që, në realitet nuk ekziston pos në mendimet tona destruktive dhe në universin tonë virtual, ndikon shumë në mirëqenien tonë fizike dhe psikologjike dhe mund të na e shkatërrojë gradualisht ndjesinë e të qenit unik.

PSE KRIJOJMË VLERA TË ÇORODITURA PATOLOGJIKE?!

Se adoleshentët ende nuk janë të sigurt për imazhin e tyre trupor, veçanërisht gjatë pubertetit, është më se normale. Por, sfida më e madhe, besa edhe

shqetësuese, qëndron në faktin se çfarë po ndodhë në shoqërinë tonë, me neve, të rriturve, si personalitete të formuar që jemi?

Cila kulturë po na infektton më shumë apo, ndoshta, meqë engjëlli dhe djalli janë brenda tek i gjalli, është ky i dyti që ka marrë udhëheqjen kur ne e shohim veten në pasqyrë?

Po harrojmë se kur imazhi i pasqyrës nuk përputhët me atë idealin në kokën tonë, ne mund edhe të krijojmë vlera të çoroditura patologjike, duke kërkuar përsosmërinë që deri tani nuk e ka arritur asnjë njëri gjatë tërë ekzistimit të njerëzimit. Sikur të reflektonim pak më shumë, nuk do të kërkonim përsosmërinë, por madhësinë unike që gjendet brenda neve, e jo në klinika estetike, atëherë, sigurisht, do të ishim më të vetëdijshëm se është pak para 12-ve për të kultivuar vlera, duke parandaluar idetë deiluzioniste të botës virtuale.

Ne, gjinia femërore, kemi një rol vendimtar në shoqëri dhe jemi udhërrëfyese për brezat e rinj në çdo aspekt dhe se ne duhet të bëhemi më të qëndrueshme sesa bota virtuale në virtetet dhe parimet tona, duke i edukuar fëmijët tanë drejt faktit se secili prej nesh është i përsosur në përsosmërinë tonë.

Nuk është bukuria jonë e jashtme, por janë vlerat tona femërore që asnjë skalpel në botë nuk do të dijë t'i zbukurojë, sepse ato burojnë nga shkëndijat e hyjnore, që krijuesi na bekoj që ne të dukemi si hyjnesha.

Shkëndije Pacolli



**PRAXIS FÜR
PSYCHOLOGISCHE
BERATUNG**
Shkëndije Berisha Pacolli

+49 152 33 63 07 73

Info@pacolli-praxis.de
www.pacolli-praxis.de

Boschring 6
56422 Wirges

Shkëndije Pacolli

BOOM

**"Dent Line" dhe Dr. Metë Shatri,
çelës suksesi për dhëmbë të shëndetshëm
e buzëqeshje holivudiane**

"Dent Line" dhe Dr. Metë Shatri, çelës suksesi për dhëmbë të shëndetshëm e buzëqeshje holivudiane

"Dent Line" është klinika dentare me shërbimet më profesionale në vend, adresë e njohur për ata që kujdesen siç duhet për shëndetin oral dhe e dinë, saktësisht, se ku ofrohen shërbimet më efikase të fushës së stomatologjisë...





PROFESIONAL, KORREKT, MË TË MIRËT...

Ordinanca specialistike stomatologjike "Dent Line" është themeluar më 14. 10. 2014 dhe prej atëherë ofron shërbime cilësore dhe korrekte për numrin e madh pacientëve që e frekuentojnë, duke filluar nga shërbimet biologjike, trajtimet endodontike të kanaleve të dhëmbit, pastrime profesionale, zbardhim profesional me laser, shërbime ortodontike, vendosja e kurorave me materiale të ndryshme (porcelan, zirkon, full zirkon, E-max), e, po ashtu, bëhet edhe vendosja e implantëve.



Rëndësi e veçantë i kushtohet trajtimet estetik të mishit të dhëmbëve (Gingivectomy), që në ordinancën "Dent Line" bëhet me anë të laserit të modelit të fundit.

Pacientë të shumë zgjedhin "Dent Line", sepse aty bëhet trajtimi adekuat profesional dhe edukativ ndaj tyre.

Të gjithë pacientët kanë trajtim të veçantë.

Kjo klinikë frekuentohet edhe nga shumë persona të famshëm, që, siç kuptojmë, kanë kërkesa më të veçanta, megjithëse trajtimi është i njëjtë për të gjithë.

Dr. Metë Shatri, përtej profesionistit të dalluar, karakterizohet edhe për njerëzillëkun e tij. E, pacientët e zgjedhin pa hamendje...

Dr. Metë Shatri, përpos shërbi-meve profesionale, ka ofruar edhe mbështetje për grupet e ndjeshme: 10 bursa për studentët e Universitetit "Hasan Prishtina", ndërsa ka dy vjet që ka ofruar shërbime dentare falas për gazetarët Ukrainas, të cilët po strehohen në Kosovë.

"Si njëherë vetë refugjat, megjithëse vetëm fëmijë, unë e kuptoj peshën e të ambientuarit në një vend tjetër, kur me mendje e zemër je gjithmonë në vendlindje", tha Shatri.

"Pra, edhe kësaj radhe, si përherë, kur m'u kërkua ndihmë, jo që nuk hezitova, por e bëra me kënaqësinë më të madhe", tha tutje.

Ajo se çfarë e bën Shatrin të lumtur është mundësia që të mbështesë rininë, me theks të veçantë të rinjtë në sport, posaçërisht femrat futboliste, siç është rasti me KFF "Shqiponja".

Për Dr. Metë Shatrin shëndeti oral është mbi të gjitha. Ndaj, edhe është shumë e rëndësishme për të personalisht dhe profesionalisht, që t'u ofrohet qasje në shërbime dentare të gjithëve, pa dallim.

Në planin afatgjatë të Shatrit përfshihen Memorandumet bashkëpunimi me sindikata e organizata të ndryshme, me anë të së cilave do të ketë lehtësime për të gjithë, si dhe shërbime kualitative të barabarta.

DR. METË SHATRI RRËFEN SEKRETIN E RUAJTJES DHE KUJDESIT ORAL

Në "Dent Line" pacientët i pret stomatologu i njohur, i suksesshëm e inovativ, Dr. Metë Shatri.

Shatri ka studiuar dhe është specializuar në fushën e stomatologjisë

në Universitetin e Prishtinës, ndërkohë ka ndjekur trajnime të shumta kombëtare dhe ndërkombëtare, në mënyrë që njohuritë t'i ngritë në nivelin më të lartë.

Është anëtar i Odës së Stomatologëve të Kosovës.

Jeton dhe vepron në Prishtinë.

"Si stomatolog dhe mbështetës i shëndetit oral, dua të theksoj se kujdesi për dhëmbët është një pjesë kryesore e shëndetit tonë.

Inkurajoj të gjithë qytetarët të kenë parasysh higjienën orale dhe ta caktojnë këtë si prioritet.

Bëni pastrimin e dhëmbëve rregullisht, përdorni pastë me fluor, përdorni penj dental dhe kryeni vizita sistematike te stomatologu juaj", thotë stomatologu Shatri.

Dëmtimi i dhëmbëve ka ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës dhe, njëkohësisht, edhe në shëndetin tonë.

Andaj, sipas doktorit, mbajtja e një rutine të rregullt të kujdesit për dhëmbët, jo vetëm që parandalon probleme të ndryshme, por, gjithashtu, kontribuon në përmirësimin e shëndetit të përgjithshëm.

"Evitoni zakonet që mund t'i dëmtojnë dhëmbët: Pirja e duhanit dhe konsumi i ushqimeve të shpejta e pijet e gazuara!

Tash, e që është aktuale në stinën e dimrit, kur qëndroni në ambientet e jashtme ku është ftohtë, evitoni pijet shumë të nxehta shkaku se ndërrimi i shpejtë i temperaturës së sipërfaqes së jashtme të dhëmbit mund të sjellë ndryshime termike në strukturën e dhëmbit, si, për shembull, plasaritjet e zmalltit".

KUJDESUNI VAZHDIMISHT PËR DHËMBËT!

Kujdesi i vazhdueshëm për dhëmbët do të sigurojë një shëndet të mirë të përgjithshëm dhe një buzëqeshje të bukur gjatë gjithë vitit, thonë në "Dent Line", ordinancën specialistike stomatologjike, që synohet dhe arrihet shëndeti oral perfekt dhe buzëqeshja juaj me pesë yje.

Për më tepër, duke pranuar shërbime nga "Dent Line", ju indirekt ndihmoni grupet e përzgjedhura nga Dr. Metë Shatri, për t'i ndihmuar qoftë me shërbime dentare, qoftë me bursa apo forma të tjera të ndihmës.

Nderim Neziri

Si duken tash të njohurat tona?

KËNGËTARJA DONIKA GASHI

Donika Gashi ka qenë tejet aktive në skenën muzikore në vitet 90. Ajo merrte pjesë thuajse në të gjitha videokasetat e asaj kohe.

Donika këndonte këngë zbavitëse, disa prej të cilave asaj kohe ishin bërë refrene dite.

Nga këngët më të njohura të Donikës janë “Të deshta, të mora”, “Ndize zemrën time”, “Besën ta kam dhanë” etj.

Përherë është veçuar për vokalin dhe stilin modern. Ku është sot Donika, motra e madhe e aktores Yllka Gashi?

Jeton në Prishtinë, ka familje, punon në profesion tjetër.



SI DUKEJ EDONA LLALLOSHI PARA 30 VJETËSH?

Këngëtarja Edona Llalloshi nuk është rastësisht në skenë.

Rrugëtimi i saj është i gjatë dhe i suksesshëm. Këngëtarja karrierën e nisi qysh herët, por u identifikua fuqishëm në festivalin e madh të “RTSH”-së. Edona u paraqit me një këngë të fuqishme në festivalin e vitit 1994, ku ajo i këndonte vajtimit të dashurisë.

Kënga “Vajtim dashurie” u bë hit i asaj kohe.



Anaderm

PËR HERË TË PARË NË KOSOVË

**ORARI I TERMINEVE PËR
KONTROLLAT DHE TRAJTIMET
ME QELIZA STAMINALE**

**Shëro problemet e nyjeve,
pa ndërhyrje kirurgjikale
me qeliza staminale**

E PREMTE

14:00 – 17:00

E SHTUNE

09:00 – 13:00

E DIEL

09:00 – 11:00

Takim me ortoped dhe ekipin
profesional të **Spitalit Anaderm**

**Rezervimet janë të nevojshme
për shkak të kërkesave**

**Nëse jeni kandidat, na kontaktoni
për të marrur udhëzimet e duhura**



**+383 (0) 45 707 744
+383 (0) 43 707 744**

Fate njerëzish...

Vitet kalojnë, ndërsa emri i saj dhe zëri i bukur e virtuoz i këngëve të saj, që mbante gjallë shtypin dhe muzikën e atyre viteve të nostalgjisë, sa vjen dhe mbetet në harresë... Kanë kaluar 18 vjet më parë, prej kur për herë të fundit këngëtarja më e njohur – ylli i muzikës shqiptare, Parashqevi Simaku, ishte ajo kur Parashqevia do të paraqitej në publik, para adhuruesve të shumtë të saj, dashamirësve dhe miqve në komunitet, në zemër të Nju-Jorkut. E, ku në mënyrë profetike Parashqevia do të dukej sikur me atë dashurinë e saj, miqësinë me të gjithë, çiltërsinë e madhe, po u thoshte “Mirupafshim për së gjalli, miq të dashur!”.

KARRIERËN E PËRFUNDOI NË NJU-JORK

Parashqevi Simaku, këngëtarja e famshme shqiptare e viteve 80-90 në Shqipëri e Diasporë, që karrierën e saj duket se e “përfundoi” në Nju-Jork, do të fotografohej atë natë dhe ndante një pjesë të miqësisë, e cila ishte dhe tipar i saj, pothuajse me të gjithë pjesëmarrësit e atij koncerti të vogël,



Cili është fati i të paharrueshmes Parashqevi Simaku?

në promovimin atë natë njujorkez të CD-së më të fundit të saj titulluar: “Echoes From Iliria” (“Jehonë nga Iliria”).

Parashqevia u fotografua me të gjithë, pa u “treguar atyre” se nuk do të “takoheshin” më, sepse jeta e saj do të merrte një “plasaritje” fatkeqe, do të përfundonte “mes një dashurie romantike dhe një ndarje tragjike me burrin e saj, Robertin.

Divorcin me burrin e saj, me të cilin kishin edhe një engjëll, djalë i “kryqëzuar” mes dy bukuri njerëzore, atë pak esmer si argjentinës nga babai dhe i bardhë e i bukur si shqiptar, veshur atë natë edhe me një kostum popullor të Shqipërisë së Mesme, nga nëna Parashqevi Simaku.

PSE I HUMBI LIDHJET E SAJ ME PUBLIKUN?

Tash, 18 vjet më pas, të gjithë pyesin se përse prej shkurtit 2006, Parashqevia i “humbi” lidhjet e saj me publikun, për t’u bërë preh e thashethemeve dhe gojëkëqijve.

Madje, për fat keq, edhe të ndonjërit prej kolegeve të saj në SHBA dhe Shqipëri!

Në mënyrë profetike Parashqevia do të dukej sikur me atë dashurinë e saj, miqësinë me të gjithë, çiltërsinë e madhe, po u thoshte “Mirupafshim për së gjalli, miq të dashur!”.

Në promovimin e asaj CD-je, e cila, për fat të keq, mbeti e fundit, morën pjesë disa nga VIP-at shqiptarë të artit e të kulturës në SHBA, mes tyre edhe Stan Dragoti, aktor dhe regjisor i njohur i Hollivudit, mjeshtri i fotografisë Fadil Berisha, artisti i njohur i fotografisë profesionale në SHBA, Dritan (Tony) Dovolani e të tjerë.

Albumi me titull “Jehonë nga Iliria”, ishte i pari album i një këngëtare shqiptare në tregun e muzikës amerikane. Kompakt disku, me 10 këngë, u promovua 11 vjet më parë, e tash mund të dëgjohet brenda gjithë dyqaneve të rrjetit “Virgin Megastores” në SHBA, ku klientët do të kenë mundësinë të dëgjojnë dhe të blejnë përmbledhjen më të fundit të muzikës popullore shqiptare.

PERFORMANCA E FUNDIT "LIVE" E PARASHQEVI SIMAKUT

Gjithashtu, për herë të fundit, ka qenë edhe performanca e fundit "live" me publikun e Parashqevi Simakut, e cila në bashkëpunim me Borders Books & Music, gjatë promovimit, këndoi "live" dhe lëshoi shumë autografe.

Atë natë folën edhe disa nga yjet e artit e të kulturës.

Ish-burri i saj, Robert Nolfë, i cili "ndoshta" ia "shkatërroi" jetën me ndarjen (divorcin), atë natë do të thoshte:

"Për mua, personalisht, është kurorëzimi i një suksesi 10-vjeçar. Dhe, unë e kuptoj fare mirë sot se çfarë kemi bërë për të nxjerrë në pah vlerat e muzikës folklorike shqiptare me bashkëshorten time, Simakun, duke mbledhur muzikën më të bukur popullore shqiptare nga të gjitha anët e Shqipërisë. Pra, kjo është një gjë shumë e veçantë dhe e gëzuar për mua personalisht dhe për të dashurën time, Simakun, djalin tim - Lukën, të promovojmë këtë CD- të titulluar "Jehonë nga Iliria". Sepse, promovimi i kësaj CD-je është promovimi i vetë vlerave të kësaj

këngëtareje, yll i muzikës popullore shqiptare.

Publiku do të jetë ai që do ta vlerësojë më mirë këtë CD, e cila bart në vetvete realizimin e një niveli ndërkom-bëtar dhe e prezanton muzikën e bukur shqiptare në nivele nga më bashkëkohoret.

Gjithashtu, ne mendojmë t'i tërheqim me muzikën tonë edhe joshqiptarët, pasi muzika ka të njëjtën "gjuhë" në të gjithë botën, e ajo është e dashur dhe e kuptueshme për çdo njeri që e dëgjon dhe e shijon".

E ENTUZIAZMUARA PARASHQEVI SIMAKU

Ndërkohë, Parashqevi Simaku, e entuziazmuar nga prezenca e shqiptarëve dhe kolegëve të saj të dashur, tha:

"Erdha në Amerikë, ashtu siç keni ardhur edhe ju me ëndrrën e madhe të "Eldorados - Tokës së Premtuar". Dhe, gjeta ngrohtësinë dhe dashurinë e madhe të këtij vendi.

Sot ndjej një nder e një kënaqësi jashtëzakonisht të madhe që në këtë promovim të gjenden kaq shumë shqiptarë në metropolin e botës, qytetin më të famshëm në



botë, Nju-Jorkun.

Sidomos, jam e impresionuar të bëjë promovimin e kësaj CD-je, në këtë supermarket librash dhe CD-esh, ku në njërin prej stendave të tij janë të publikuar edhe librat e studiueses angleze, e që shkroi për Shqipërinë e shqiptarët, Edith Durham.

Kisha një ndjenjë të madhe shqiptarie, e cila ma ka ndezur zëmrën sot, sa që edhe djalin e kam veshur me kostum popullor".

Beqir Sina

Më ka ndodhur gjithnjë që kur më ka pëlqyer një femër të vrapoja shumë gjatë pas saj, derisa ta bëja për vete ose të mos më ecte fare me të – ndërkaq rasti i fundit që më ka ndodhur, është diçka e papërshtueshme.

E tëra ka nisur me një telefonatë të gabuar dhe prej atij momenti gjithçka ka nisur spontanisht.

Një herë më ka thirr ajo dhe më është betuar se ka kërkuar një të afërm familjar në numrin tim, mirëpo e vërteta ishte se ajo e kishte ngatërruar vetëm shifrën e fundit të numrit. I kam thënë “alo” dhe e kam dëgjuar një zë të ëmbël femre, e cila më ka kërkuar falje, por unë nuk e kam lejuar që t’ma ndërpres lidhjen.

E kam thirrur unë pas pesë minutash po në atë numër që më doli në mobilin tim, e kam pyetur si e kishte emrin, sa vjeçare ishte dhe prej nga ishte.

Më ka treguar pak nga pak për gjithçka nga jeta e saj, edhe pse disa herë në fillim më kishte ndërprerë lidhjen dhe kishte kërkuar nga unë që ta lija të qetë. Mirëpo, unë vazhdimisht ia kisha cingëruar telefonin, i kisha dërguar mesazhe deri në momentin kur kisha marrë përgjigjen që e kërkoja prej saj se ajo nuk kishte asnjë të dashur momentalisht dhe kjo më mundësonte që të insistoja edhe më tutje në përvetësimin e saj.

Dëshira ime u rrit edhe më shumë kur ajo po më tregonte se ishte seks-bombë e vërtetë, gjë që nuk i zija besë aspak deri në atë çast kur më doli përpara si princeshë e vërtetë, e unë si një tip i thjeshtë që nuk i afrohesha askund. Më duket se kam qenë djaloshi me fatin më të madh në jetë që kam arritur ta bëj një femër pa u munduar shumë, siç isha lodhur e shtjerrë kushedi sa palë këpucë me femra të tjera. Vetëm kur ia arrita që ta kisha në shtrat, u binda se, me të vërtetë, femrat të duan vetëm atëherë kur je maksimalisht i singertë: i tregova se jam i martuar, ndonëse askund nuk më shkruante në ballë që isha edhe baba i dy fëmijëve...



Me 25 euro në xhep e përvetësova femrën më të bukur që e kam pasur në jetë!

E njoha në një mënyrë mjaft interesante, përmes telefonit. Shpesh dëgjohehim në telefon dhe sidomos kur unë kujdestaroja natën në punë. Isha shumë kureshtar që ta njihja dhe ia arrita qëllimit. Ishte vajzë e bukur, mjaft tërheqëse, me këmbë të bukura dhe kështu filloi çdo gjë. Kështu më kishte thënë në telefon kur e kisha pyetur sesi dukej dhe ajo gjithnjë kishte thënë se ishte femër simpatike. Por, unë nuk i besoja dhe, zakonisht, mendoja se femrat që thonë se janë të bukura, mund të jenë të shëmtuara ose anasjelltas. Rastësisht kishte thirr në numrin tim dhe prej asaj dite filluam të komunikonim me njëri-tjetrin, pa u njohur dhe pa u parë.

Thënë të drejtën, edhe frikësohesha të shkoja nga Peja në Prishtinë për të, sepse dyshoja se ajo mund t’më mashtronte dhe të mos më dilte fare në takim.

FEMRAT VETËM ME SINQERITET I PËRVETËSON

U nisa për në Prishtinë, të dilte ku të dilte, me vetëm 25 euro në xhep. E kishim lënë të takoheshim pasdite në afërsi të Postës së Madhe dhe ajo paraprakisht më kishte përshtuar veten se çfarë do të vishte atë ditë.

Unë, me qëllim, në vend se t'i thosha se do të vishesha ashtu siç isha me të vërtetë, i kisha thënë se isha krejt në të zeza, ndonëse kisha të veshur farmerka dhe një këmishë të kaltër.

Nuk mund ta imagjinoja veten në një pozicion të poshtërit, nëse ajo nuk do më dilte në takim.

Mirëpo, kur shkova në vendin e caktuar, nga larg pash një vajzë ashtu siç ajo e kishte përshkuar veten, e cila priste duke shikuar orën në dorë. I shkova nga prapa dhe duke e ditur se ajo ishte, iu prezan-tova, duke i buzëqeshur.

Të parën fjalë që ia thashë ishte pyetje direkte: "A po të pëlqej?"

Po atë çast ajo më shikoi nga këmbët deri te flokët dhe, duke menduar se do ta thoshte të vërtetën se unë nuk isha tip që i përshtatesha asaj, ma kthehu:

"Nuk ka rëndësi për mua bukuria e jashtme!"

Dhe, mu këtë përgjigje e dëshiroja prej saj dhe gjatë gjithë kohës sa ecnim njëri pranë tjetrit e shikoja trupin e saj të bukur, flokët bionde dhe jashtëzakonisht tërheqëse.

Nuk dija çfarë t'i thosha dhe vendosa të mos e gënjeja asgjë, sepse, mendova me vete, vetëm me sinqeritet do ta përvetësoja. Ashtu edhe ndodhi. Ecëm disa hapa duke folur diçka të parëndësishme. Ajo tregonte se kishte ardhur pesë minuta para kohës në takim. Ajo nuk dukej të kishte më pak se pesë-gjashtë vite më e re se unë, mirëpo nuk mund të krahasohej për asnjë moment me mua.

MENDOJA SE ISHA NJËFARË TIPI, POR KARSHI SAJ ISHA NJË ASKUSH!

Thënë sinqerisht: deri atëherë më ishte dukur vetja njëfarë tipi, por afër saj ia mora vetes inati në ato momente.

Mirëpo, këtë mendim të keq për veten time nuk e kishte ajo, sepse e vërejta se më shikonte me kënaqësi dhe nga kjo hetoja njëfarë simpatie të çuditshme të saj ndaj meje.

Thjesht, kjo gjë më befasonte dhe më bënte ta ndjeja veten disi krenar, të hareshëm dhe me humor të mirë. Doja të bëja gjithçka që ishte e mençur vetëm e vetëm që të mos e humbja, të mos më refuzonte dhe, në fund të fundit, nuk doja që të kthehesha duarthatë nga udhëtimi im enkas vetëm për të nga Peja.

Ajo më tha se do të shkonim në një lokal të qetë për të pirë kafe dhe për të biseduar dhe unë pranova menjëherë.

I thashë se e kisha lënë veturën të parkuar më poshtë, ndërkaq ajo propozoi që të

uleshim fillimisht diku dhe, pastaj, mund të dilnim të shëtisnim.

SI T'I TREGOJA SE ISHA I MARTUAR?!

Asgjë nuk më pengonte, sepse e dija se askush nuk më njihte në Prishtinë dhe kjo ishte lehtësi e madhe për mua.

Paramendo sikur të ishim në Pejë, as që do të guxoja të bëja një hap në shoqëri me këso femre, sepse... isha burrë i martuar dhe ajo nuk dinte gjë.

Isha në hall të madh se a duhej t'i tregoja apo jo të vërtetën time?! E dija se ajo menjëherë do të mund të ngrihej në këmbë dhe do të shkonte. Unë isha i gatshëm kushedi çfarë të sakrifikoja vetëm që ta kisha në dispozicion atë ditë dhe ende nuk e dija se a do t'ia arrija qëllimit tim aq shumë të dëshiruar. Vendosa që vetëm rrugën e drejtë ta ndjekja dhe, për fatin tim më të mirë, më ndihmoi Zoti...

Dhe, derisa zihesha në vete se çfarë duhej të bëja me atë bukuroshe, e që tani e kisha përballë, kamerieri më shkundi memorien. I thashë se kërkoja një lëng molle dhe u ktheva kah ajo ta dëgjoja me vëmendje derisa më tregonte gjithçka për veten... Mezi po arrija ta dëgjoja kur thoshte se e kishte emrin Vesë, se ishte 25 vjeçe dhe jetonte në Prishtinë.

Kaq. Nuk më tregoi asgjë tjetër personale dhe mendova me vete, ndoshta, edhe kjo është duke fshehur diçka nga jeta e vet?! Tash e dija se, menjëherë më pas, duhej t'i flisja unë për vete... Vendosa aty për aty që të mos i tregoja menjëherë se isha i martuar, sepse doja ta lija për më vonë... I thashë se e vetmja arsye që më kishte shtyrë të vija në Prishtinë ishte fakti i thjeshtë se kisha dëshiruar të zbuloja se kush fshihej pas atij zëri të bukur në telefon.

I tregova se kisha agjenci turistike në Pejë dhe gjatë verës organizoja udhëtime për pushime veriore në Ulqin dhe Shqipëri. E shihja sesi i interesonte çdo gjë që nxirra nga goja dhe më habiti sesi nuk më pyeti fare për atë që i frikësohesha më së shumti: A isha i dashuruar apo i martuar?! Në fund të fundit, e dija se nuk më shkruante askund në ballë se isha i martuar dhe isha prind. Më gëzonte fakti se asaj po i pëlqente biseda me mua dhe, gjithashtu, i rrihej me mua...

...E SKUQUR SI HEKURI NË ZJARR!

Nuk mund të përshkruaj sesi dukej ajo në ato çaste: e ndezur pak në fytyrë, me buzë të kuqe dhe me një buzëqeshje që kurrë nuk i largohej nga fytyra.

Isha i lumtur, sepse e parandieja se do të

më ecte me të dhe nuk do të më shkonte huq rruga që kisha bërë deri këtu...

E ndieja se asaj po i pëlqente atmosfera e krijuar dhe, në të njëjtën kohë, mund ta vëreja se deri-diku, që në takimin e parë, po e bëja për vete një femër të bukur. Ashtu edhe më doli rezultati, sepse pas pak ajo vetë tha se do i pëlqente të dilnim të shëtisnim.

Shkuam deri te vetura ime, hipëm dhe bëmë disa gjiro nëpër rrugët e Prishtinës, e që nuk i njihja mirë.

Ajo më tha se ku dëshironim që të shkonim tjetër, ndërkaq unë i rrudha supet dhe e lija në dorë të saj, sepse isha "mysafir special". Shkuam në një restorant në Gërmir, ndenjëm pak dhe prapë u kthyem në Prishtinë. Kur erdhëm në një bllok ndërtesash në Lagjen "Ulpiana", më tha ta parkoja aty veturën dhe më propozoi të ngjiteshim në banesën e saj në katin e katërt të një ndërtese shtatëkatëshe.

Unë bëja çka thoshte ajo dhe disi luaja një lojë fëmijësh me të: paraqitesha krejt ndryshe nga ç'isha në të vërtetë...

Mirëpo, vërehej sheshazi se asaj i pëlqente deri atëherë çdo gjë imja dhe për këtë arsye nuk bëja zë.

Nuk kisha asgjë për të thënë, asgjë për të kundërshtuar, sepse fundja çka do të mund t'më lidhte tjetër me atë vajzë të bukur përveç një dite të bukur, të paharrueshme dhe të papërsëritshme. E dija mirë se po më plotësohej dëshira: po afrohej momenti i shumëpritur, sepse kur i pëlqen një femre, ajo nuk pret lutje...

E MARTUAR SA PËR SY E FAQE...

"Këtu jetoj unë, e vetme dhe e shumëvuar për gjithçka!", më tha kur e hapi derën e më tha të hyja brenda...

Pastaj, hodhi në dy gota nga pak verë të kuqe dhe erdhi e u ul pranë meje...

Tash, thënë të drejtën, nga pak edhe frikësohesha prej saj, sepse kisha hyrë në banesën e një femre të cilin ende nuk e njihja mirë...

Pas disa minutash ma mori gotën nga dora dhe u ngritë në këmbë.

Kërkonte që të fillonim me puthje, mirëpo ende isha në mat-pozicion...

Ajo e vërejti këtë dhe insistoi që t'i tregoja pse isha i trembur...

"Jam i trembur, sepse edhe unë jam i martuar!", i thashë, duke mos ia fshehur të vërtetën time.

E, kur prita se kjo do të ndikonte negativisht te ajo, m'u ul në prehër dhe më tha:

"Sot po i tradhetojmë ti gruan e unë burrin tim që nuk e kam parë qe një muaj!"

E, në mbrëmje vonë, mezi kam dal nga banesa e saj...

F. E.



Pse në Kishnapolë të Gjilanit për një gotë uji paguam një lirë?

Në verën e vitit 1970 ishin bërë të gjitha përgatitjet për ta marrë nusen Hanife për djalë të xha Sylushit. Ishin blerë dy sandëk dhe në të ishin vendosur gjërat që i përkisnin nuses. Pra, paja e nuses...

Në njërin nga sandëkët ishte një letër, në të cilën ishin shkruar të gjitha gjërat që i kishte kërkuar familja e nuses, duke filluar me pesë lirshin, dy lira të vogla, e kështu me radhë.

Përgatitja për dasmë, veç të tjerash, nënkuptonte edhe dërgimin e rrobave dhe të gjëseneve të tjera nuses. Dhe, e diela, zakonisht, ishte dita e dasmës, kur edhe merrej nusja. Atë vit unë isha shumë i ri. Më kujtohet se hipëm në qerre dhe udhës që e prente disa herë lumi "Klisyarka", duke u ruajtur të mos na prekte koka në degë lisash malorë, shkuam në fshatin Kishnapolë për ta marrë nusen.

PRITJA NË LIVADHIN E MADH

Kur arritëm në Kishnapolë, pritjen na e kishin bërë në një livadh të madh, afër shkollës.

U ulëm në livadh, ku binin rrezet e nxehta të diellit veror dhe secili prej nesh mendohej të gjente një pozitë që t'ia kthenim shpinën diellit, sepse

drita e fortë e tij pengonte t'i shihje njerëzit në fytyrë...

Posa u rehatuam pak, erdhën gotat me ujë të ftohtë, ujë ah, siç thanë miqtë.

Dhe, pasi i mblodhën gotat e zbrazëta, në vend se të ngriheshim se kishim ndenjtur mjaft, një nga miqtë tha: "Le të tregojë kush e ka marrë një gotë ose dënimi është një lirë!".

Njerëzit filluan të shikoheshin ndërmjet veti...

Por, edhe ta fshehje gotën ishte vështirë, meqë gjithsecili prej nesh ishte i veshur me rroba të holla vere dhe në xhepat e teshave të verës nuk kishte si ta fshihje gotën e ujit, e cila jo vetëm që ishte e madhe, por edhe e trashë.

Po ai e përsëriti edhe një herë se një gotë mungon dhe pa treguar se kush

e ka marrë, nusja nuk hip në qerren e nuses...

E, urdhri i mikut u bë prekës, sepse ai që e kishte "marrë" apo e kishte "fshehur" turpërohej të tregonte...

Gota nuk u gjet te askush.

Dhe, pas një kohë pritjeje, si kusht për ta marrë nusen, po ai që e kërkonte gotën tha se miku duhej të paguante në vlerë të një lire...

Dhe, tek pasi i tubuan të hollat dhe iu dhanë personit që kishte dhënë kushtin, u bë teslimi, u zbraz pushka dhe u nisën krushqit.

E, kur u kthyen krushqit në shtëpinë ku ishte dasma, Arifi, aso kohe rreth të gjashtëdhjetave, tregoi se gotën e kishte hedhur prapa shpine në një kaçubë dhe i kishte ardhur turp të pranojë se gabimi ishte i tij...

S. Mururi



Revolucion në DOBËSIM

E themeluar në vitin 2011 nga Shkenda Dubova, me një qendër fillestare në Prishtinë. Rugëtimi ynë nisi në një kohë kur aparaturat nuk njiheshin në vendin tonë. Qendra jonë solli një inovacion për tregun Kosovar dhe jo vetëm. Kjo na bëri të ndihmojmë shumë njerëz duke përbushur ëndrrat e tyre.



Perforco
vaten



Detoksifikohu



Relaksohu



Balanco
Shëndetin



PARA



PAS



PARA



PAS



PARA



PAS

Prishtinë

+383 45 224 540

Prizren

+383 43 900 902

Gjilan

+383 45 505 043

Gjakovë

+383 44 545 444



Kurbetçarët takohen me dreqër e zana!

Dy burra, e që nga kurbeti udhëtonin për në vendlindje, kishin arritur në fshatin e tyre aty kah ora dy pas mesnate.

Por, kur kishin arritur te livadhet e fshatit të tyre, kishin dëgjuar një muzikë dasmash të asaj kohe, që përshkohej nga tupanë e surle...

Posa ata arritën te livadhet, në një moment para tyre kishin dal një mori burrash të mëhallës, duke i mirëpritur në dasmë dhe duke i falënderuar që kishin ardhur me kohë...

Por, burrat që u kishin dal në pritje, siç thuhej në popull, ishin qoftëlargët! Në muhabet e sipër, të dy të sapoardhurit, i kishin ulur në krye të vendit në odë.

Ishin ulur nëpër shilte sfungjeri dhe gjatë gjithë kohës hanin, pinin e bënin muhabet...

Por, ata që shtireshin si burrat e mëhallës, në fakt, ishin demonë, me pamje të njerëzve të njohur.

SI U BINDËN SE KISHIN QENË ME DREQËR?!

Me të kënduar gjeli i parë, demonët ishin larguar në shpejtësi dhe të dy

burrat e kishin parë veten të vetmuar në livadh...

Dhe, filluan të shikohen ndërmjet veti...

Më i moshuari, me ta shikuar shokun, filloi të qeshë me zë të lartë.

"Gojën e ke përlyer me bagla! Bagla ke hëngër, a?!", i thotë.

"E ti, a po e sheh veten?! Edhe ti buzët i ke me bagla!", ia kthen ai.

"Jo, e kam prej duhani", i përgjigjet ai.

"Jo prej duhani, por prej baglave!", mundohet ta bindë ai.

Dhe, nisin të bisedonin se ishin në dasmë...

Por, si ndodhi që gojën ta kenë përlyer me bagla, kjo habiste...

Andaj, i riu e pyet më të vjetrin:

"A ishim në dasmë, bre?!".

"Po", i thotë ai.

"E, ku mbeti muzika?!".

Dhe, filluan të shikojnë anash...

Askund s'ka tupanë e as surle!

Dhe, erdhën në përfundim se qoftëlargët i kishin grumbulluar bajgat e livadhit dhe ua kishin dhënë për t'i ngrënë në vend të ushqimit...

E, kur u bindën për këtë gjë, ia plasën gazit dhe nuk dinin të ndaleshin...

KREJT MËHALLA QESHTE ME KURBETÇARËT!

Të nesërmen atë ndodhi nuk e mbajtën fshehtë, por ua treguan familjarëve, të cilët mbetën të habitur...

Dhe, kështu, për atë ndodhi mësoi e tërë mëhalla, tërë fshati dhe nisën të qeshnin me ta...

Sidoqoftë, erdhën në përfundim se ishin takuar me dreqër dhe bashkë me ta kishin kaluar një pjesë nate në livadhet e fshatit...

S. M.



Kunatën e kam dreq!

Po jetoj e shantazhuar nga kunata. Më ka thënë se nëse nuk bën si të them, ta marrë burrin!

Jam martuar para 10 vjetësh në një familje të mrekullueshme. Në fillim të ditëve të para të martesës im burrë më tha: "Familja ime është e qetë. Nëna nuk të përzihet në jetë, nusja e vëllait të dytë e shikon punën e vet, por nusja e vëllait të madh është dreq. Dhe, pikërisht, kunata e madhe u afrua shumë me mua... Më pyeste për kurset që i kisha bërë si frizere dhe ia rregulloja flokët sipas dëshirës së saj. Ndërkohë, fillova edhe një kurs për

flokët dhe tek atëherë e vërejtja se kunata ishte xhelozë në mua. Kështu, ajo më shfrytëzonte mua pa e kuptuar unë. Mua më thoshte: "Shyqyr që erdhe ti e po kemi mirëkuptim se këta janë dreqër!"

SI RRODHI GRACKA E KUNATËS?

Në vitin e dytë të martesës mbeta shtatzënë. Vizitat i bëja në Prishtinë, aty ku kisha lindur, meqë i njihja mjekët. Para se të lindja shkova për të lindur në spitalin ku thashë se i kisha bërë vizitat. Dhe, deri këtu gjithçka shkoi mirë... Familja ime u gëzua shumë... Vjehrra dhe burri erdhën të më shihnin një ditë para se të lindja. Të nesërmen linda djalë.

FËMIJËN E KISHA ME "MJEKUN E SPITALIT!"

Por, problemet lindën pas lindjes së fëmijës. Kunata e madhe, pra "dreqi", nisi të përhapë lajmin se fëmijën e kisha me njërin nga mjekët, që më kishin kontrolluar rregullisht gjatë gjithë shtatzënisë! Vjehrra ime çfarë s'i kishte thënë, por ajo e kishte kurdisur planin e saj se si kinse më kishte dëgjuar në korridor duke biseduar në telefon me njërin nga mjekët. Pra, ajo kishte filluar lojën, lojë që unë s'e kuptoja... Dhe, shumë shpejt filloi terrori në shtëpi. Burri im nuk më jep një përkrahje, por duron... Sikur edhe ai dyshon në mua... Keq. Shumë keq!

Majlinda, Mitrovicë

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Gruaja më është bërë e dyshimtë!

Jam nga Hasi i Prizrenit. E kam një fëmijë që rritet me nënën e vet, me të cilën jemi ndarë, shkaku se dyshoja se më tradhtonte, edhe pse vetë e dërgoja në punë dhe e merrja nga puna.

A do të ribashkohem me gruan dhe a më ka tradhtuar apo ende më tradhton?
(Emrat dhe datat, ju lutem, mos i publiko!)

“Besniku”

Përgjigje:

Nuk shoh se ka pasur tradhti te gruaja jote, sepse ka qenë shumë korrekte.

Në fakt, ke thënë edhe ti se vetë e ke dërguar në punë dhe vetë e ke marrë nga puna...

Ajo punon në mesin e 80 vetëve. Dhe, në atë mes të madh, nuk ka pasur mundësi të bëjë tradhti...

Te ti, fatkeqësisht, mentaliteti është i tillë që mendja të rri vetëm te tradhtia!

E, karakteri e mentaliteti janë dy dispozita shpirtërore, të cilat rrjedhin nga rrethi.

E, rrethi është determinues i

bërthamës psikike.

Pra, ka intelektualë me doktraturë, por nuk mund ta kalojnë pragun e karakterit kundër gruas, sepse ashtu është lidhur truri i tyre me paragjykim, sikur që lidhet fryti i pjeshkës rreth bërthamës.

Kështu, pra, nuk të ka tradhtuar gruaja, por të ka tradhtuar karakteri yt, e që vjen nga rrethi yt!

8 vjet ia fala djalit që e dua dhe nuk fitova gjë!

Jam vajzë, 27-vjeçare, nga Prizreni. Kam humbur çdo gjë për një djalë që e dua.

Jam bashkë me të që nga mosha 19 vjeçe dhe kurrë nuk kam pasur probleme deri në kohën kur gjatë verës shkoi në Turqi, kinse për të punuar.

Për lidhjen dinë të dy familjet tona, të cilat kanë bindjen se çdo gjë duhet ta zgjidhim unë dhe ai, pa ndërhyrje anash.

Të lutem, a do të jemi bashkë, sepse vetëm atë e dua dhe si do të ndodhë e ardhmja e tij?

“E dërrmuara”

Përgjigje:

Jeni 8 vjet bashkë, e dinë familjet tuaja dhe nuk e keni zyrtari-

zuar fejesën, nuk i keni dhënë vulë legjitimitetit të dashurisë suaj?!

Por, nuk je në shtëpinë pa derë, prej nga nuk ke dalje. Ti ke sa të duash zgjidhje me atë person, sepse ai nuk ka hequr dorë prej teje.

Ai po kërkon një siguri për ekzistencë.

E, pa ekzistencë ekonomike nuk mund të bëni martesë.

Sepse, jeta nuk është vetëm dashuri. Kuptimi i të dashuruarit nuk bazohet vetëm në dashuri, por shumë më shumë në ekzistencializëm, diçka që ju nuk e keni tani.

Pra, asgjë nuk ke humbur pse ai ka shkuar në Turqi, por ti ke fituar shumë.

Ai në Turqi e ti ta gjesh një punë të përkohshme, do të jetë një përvojë perfekt që ju të bëheni më të pjekur dhe të shihni përtej hundës dhe aty, pastaj, do të bindeni a jeni për njëri-tjetrin. Sidoqoftë, do vijë koha kur do të jeni bashkë, sepse u shoh bashkë...

Ndryshimet te burri më lëndojnë shumë!

Jam grua 32-vjeçare, nënë e dy fëmijëve. Burri më ka qëndruar shumë pranë, por ka një vit që, disi, shoh një ndryshim të madh te ai!

Më shumë është dhënë pas shokëve sesa pas meje!

Kjo po më shqetëson, sepse shumëçka sot po rrjedh nga shoqëria e, pastaj, po dalin probleme edhe në familje.

Më keni ndihmuar shumë në

një rast, e që lidhet me burrin, për çka u jam shumë mirënjohëse.

Më thuaj, pse burri im ka ndryshuar?

“Zonja nga Suhareka”

Përgjigje:

Është një shtresë zonjash që tërë jetën luftojnë për ta ndryshuar burrin, për aq sa u duhet atyre.

E, kur arrijnë ta bëjnë ndryshimin, ankohen duke thënë se burri ka ndryshuar!

Kjo është ambicia e grave që shpeshherë duan ta ndërrojnë burrin për ta vënë nën komandën e vet, në mënyrë që ato të jenë “pak të lira” për jetë personale. E, kur e arrijnë qëllimin, atëherë duan sërish kujdesin e burrit në mënyrë maksimale!

Në këtë pozicion je edhe ti, që ke punuar me vjet për ta ndryshuar burrin.

Prandaj, mos i shiko gjërat në imtësi, sepse imtësitë shpesh bëhen probleme të pakalueshme.

Nuk shoh se diçka po punon pas shpinës tënde prej anës së burrit.

Andaj, mos hap plagë!

E kam dashtë, por tash nuk e dua burrin!

Përhëndetje zonja magjistare! Jam 34-vjeçare, jetoj në Prishtinë.

Jam martuar qe 5 vjet, por nuk e dua burrin!

Jam e shtrënguar të duroj kështu deri në fund të jetës apo do më lerë ai mua, për çka do më bënte të lumtur po

të ndaheshim.

Çka do pres në jetë nëse ndahem, apo do të vazhdoj jeta ime me shumë të panjohura?

“Dua të ikë nga martesë”

Përgjigje:

Ti ke qenë shumë vjet në lidhje me njeri të martuar, por nuk të ka bërë zgjidhje.

E, as nuk është pritur të bëjë diçka më shumë!

Prandaj, familja jote, duke mos pasur rrugëdalje tjetër, ka vendosur martesën tënde me dikë që është i ndarë pas 8 vitesh martesë, të cilin me kohë je dashuruar në të...

E, tash, nëse ti ndahesh prej tij apo nëse ai të lë ty, ti do i rikthehesh lidhjes së vjetër, andaj po mundohesh të kthesh aty ku do...

Sidoqoftë, ti nuk ja bën burrit jetën e lumtur përderisa grindeni çdo ditë e çdo natë, duke jetuar me inate kundër njëritjetrit.

Ti, duke mbajtur inate që ai të të dëbojë nga shtëpia, e ai duke bërë inate të të mos lëshojë të ikësh prej tij, asnjëri nuk e keni jetën të lumtur, për çka sugjerimi im është të ndaheni.

E, edhe ndarja është normale, ashtu sikur edhe bashkimi.

Përdore korrektësinë për të biseduar shtruar me burrë, duke e hapur shpirtin e njëritjetrit mbi atë që ju mundon dhe, kështu, do të vini te një zgjidhje për t’u ndarë apo për të vazhduar së bashku...

E zura burrin me “pelë për dore”!

Përhëndetje, jam 25 vjeçe,

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

jetoj jashtë Kosovës. I kam dy fëmijë.

Ka një kohë që unë dhe burri zihemi, qoftë edhe për asgjë! Para një viti e ka pasur një lidhje me një vajzë, por e hetova dhe thotë se më nuk ka lidhje me të...

A ka ndonjë lidhje të re tash? A na ka bërë kush sehire?

“Gruaja nga Zvicra”

Përgjigje:

Ka raste që burrin është mirë mos me e zënë në flagrancë, në vepër!

E, arsyeja pse grindeni është thikë me dy tehe:

Tehu i parë është se ti je mbushur xheloz shkaku i asaj lidhjeje që e ka pasur burri, ndërsa ai është mbushur inati që ti e ke zënë në flagrancë! Pastaj, ti e ke hapur një portë rreziku, sepse çdo gjë që ai e bën, keq a mirë, ti ia përmend gabimin, ndaj së cilës sjellje ai reagon me inati edhe më të madh.

E, në këtë mënyrë, në vend se ta harroni inatin, ju e kultivoni edhe më shumë.

Andaj, ajo që duhet ta bësh ti, pa humbur kohë, është ta harrosh rastin e lidhjes së tij...

Dhe, jo vetëm ta harrosh, por edhe t’i thuash se e ke harruar, sepse për ju më e mira gjë është ta riktheni besimin te njëritjetri.



GJITHKUSH NUK HANË KASHTË...

Po bisedonin dy vetë në një dhomë të burgut në Kosovë. Njëri, që sapo ishte dënuar me 6 muaj, e kishte plaçkitur bankën.

E, tjetri, që ishte aty më rezident, kishte vjedhur një qerre kashtë me një arë.

I burgosuri për kashtë e pyet grabitësin:

“Sa të dënuan, bre burrë?”

“Gjashtë muaj! Mos pyet çka më ka gjetur, por s’kam çka të bëj!”

“Vetëm gjashtë muaj të dënuan për vjedhje të bankës, a?! E, mua 12 vjet pse e kam vjedhur një kerr kashtë!”

“Po, sepse ata në gjyq nuk hanë kashtë!”

“Mirë e ke, he burrë, se kurrë s’ma ka rrok truri këtë përgjigje!”

SECILI SHKRUAN POEZI!

Në kohën e Nastradinit, në qytetin Ak Shehir, gati çdo njeri shkruante poezi. E, ai që nuk

shkruante nuk çmohej fare.

Një qytetar ishte bërë merak të bëhej poet i madh.

Dëshirë kishte, por mundësi jo!

Një mëngjes, me të dalë nga shtëpia, takon Nastradinin dhe, pasi e përshëndet, ia bën pyetjen:

“Hoxhë efendi, ti, si njeri i mençur, çfarë më këshillon të bëj që të jem poeti më i madh i këtij vendi?”

Hoxha i thotë:

“Që të jesh më i madhi i poetëve, mos ia prano askujt poezitë, mos i lexo shkrimet e askujt! Kështu, poezitë tua do të mbetën më të mirat!”

SI KALOHET FESTA PA E NGRITUR ASNJË GOTË?!

Posa e kaluam festën e Vitit të Ri, një fqinj imi, që e kishte të ndaluar konsumimin e rakisë, kur e pyeta si e kalove festën, më tha:

“Po, si kalohet Viti i Ri pa pirë asnjë gotë, bre?!”

Dhe, në çast m’u kujtua veprimi i Nastradinit, kur ishte sugjeruar nga mjeku se sa gota mund t’i pinte...

Nastradini, meqë ishte i sëmurë, shkon te mjeku dhe i thotë se ishte shumë keq.

“Që të jetosh duhet ta lësh pijen, përndryshe përgatite varrin!”, i thotë mjeku.

“Doktor, vështirë është ta ndër-pres menjëherë pijen, por pak si ngadalë ndoshta...”, ia kthen Nastradini.

“Mirë, hoxhë efendi, pi të shtunave nga dy gota verë dhe më asnjë tërë javën!”, i thotë mjeku.

Dhe, pas dhjetë ditësh mjeku shkon ta vizitojë Nastradinin. E gjeti në shtrat të dehur...

“Nastradin, ti përsëri po pi, a?!”, i thotë.

“Doktor, vetëm dy gota i kam pirë. Gotat janë në dollap”, ia kthen ai.

Ngrihet mjeku t’i sheh gotat dhe çfarë të shihte: gotat ishin të mëdha, aq sa secila do zinte nga një litër verë...

S. M.

Zëri s'u shkon, të famshme po!



Blerta Jakupi



Jehona Dreshaj



Nita Istrefi



Mani Ismajli



Uindi Haxhia

Jo të gjitha motrat kanë mundur të bëhen këngëtare, ama të famshme janë bërë gjithsesi, bie fjala, Blerta e Leonora Jakupit ose Nita e Nora e Era Istrefit. Gjithashtu, e njohur falë motrës është bërë edhe Uindi, motra e Encës.

E, në këtë renditje hyn edhe Mani, motra e Genta Ismajlit, që gëzon famë në shpinë të së motrës. Nuk përjashtohet as Jehona Dreshaj, që duhet t'i falënderohet Afërditës, por edhe gjoksit që ka.



DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE